



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-001

Prishtinë, më 21 shkurt 2011, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 21 SHKURT 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha dhe Sherif Konjufca;

Nga ZCN: Blerta Bejtullahu.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Shqyrtimin e kërkesës së Grupit të Grupit Parlamentar të PDK-së.

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me përmbajtjen e kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së, me të cilën kërkohet plotësimin e rendit të ditës të mbledhjes plenare edhe me dy pika shtesë, si vijon:

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe
2. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Lidhur me kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së, me të cilën kërkohet plotësimin e rendit të ditës të mbledhjes plenare edhe me dy pika shtesë, diskutuan: Xhavit Haliti, Glauk Konjufca, Sabri Hamiti, Petar Miletqi dhe Enis Kervan. Diskutimet e plota janë dhënë në Transkript.

Kryesia, pas diskutimeve lidhur me kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së për plotësimin e rendit të ditës të mbledhjes plenare edhe me dy pika shtesë,

V E N D O S I

Kërkesa e Grupit Parlamentar të PDK-së për plotësimin e rendit të ditës të mbledhjes konstituive të Kuvendit me dy pika shtesë: Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Zgjedhja e Kabinetit qeveritar, nuk është në përputhje me nenin 42, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 13:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Hartoi: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale